



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Departamenti i Prokurimit

Data: 03.04.2025

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Lipjanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 28.03.2025 të parashtruar nga **OE A&G GROUP SH.P.K.** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “**Mirëmbajtja e infrastrukturës në qytet dhe fshatra**” me nr. të Prokurimit **613-25-1158-2-1-1**, Autoriteti kontraktues nxjerr:

V E N D I M

Pranohet si Pjeserisht e Bazuar, kërkesa për ri-shqyrtim **OE A&G GROUP SH.P.K.** të dt. 28.03.2025 lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Mirëmbajtja e infrastrukturës në qytet dhe fshatra**” me nr. të Prokurimit: **613-25-1158-2-1-1**

AK do të ndryshoj kërkesat e nevojshme dhe të njëjtat do të publikohen në platformën e Prokurimit sipas LPP-se

Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të lartëpërmendur dhe ndryshimet do të paraqiten në platformën e prokurimit dhe do njoftoheni me B54 Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara

1. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetim

Pretendimi ankimor 1

*Cilinder me dhembëza min 24 = 1 cope

Ky kriter i ngushtë krijon pengesa të panevojshme për operatorët ekonomik të cilët mund të ofrojnë makineri të përshtatshme për realizimin e këtij projekti të marrin pjesë të tender, vendosja e këtij kriteri konsiderojmë që është një mundësi për të ju përshtatur kërkesat për disa kompani të caktuara, duke i eliminuar plotësisht konkurrentet e tjerë, dhe kjo bën në kundërshtim të plotë me Ligjin e Prokurimit Publik.

Në shumicë rast raste, kërkesat për një gamë kaq të ngushtë të tonazhëve është e panevojshme për realizimin e projektit, tonazhi nuk duhet të jetë një faktor kufizues, mirëpo kjo është një praktikë që favorizon operatorët ekonomik të caktuar që i kanë keto pajisje kaq specifike, mirëpo që është e panevojshme për natyrën e projektit sepse askund në asnjë pozicion të paramasës nuk është elaboruar pse është e nevojshme kjo pajisje për implementimin e këtij projekti, prandaj konsiderojmë që vendosja e kësaj pajisje në kriteret e dosjes së tenderit dhe njohimit për kontratë është plotësisht në kundërshtim me dispozitat ligjore të prokurimit publik dhe si e tillë duhet të largohet ky kriter ose të ulët tonazhe e tij në mënyrë që mos të kufizoj konkurrencën dhe të jenë në harmoni me dispozitat ligjore të prokurimit publik.

Pergjigje per pretendimin tuaj te pare:

Duke analizuar unkesen tuaj per pretendimin tuaj te pare AK kete pretendim e vlereson si pjeserisht te bazuar dhe AK do te zvoglon peshen e kesaj paisje.

Pretendimi juaj i pare eshte Pjeserisht i Bazuar

Pretendimi ankimor 2

*Gjysëmrimorikoe për mbushje të plasaritjeve të rrugeve me sperkates me emuluzion = minimumi 1 cope

Ky kriter shkel parimet e barazise dhe transparences te peraktuara ne ligjin e prokurimit publik, duke vendosur ju si Autoritet Kontraktues kerkesa kaq te ngushta dhe te papershtatshme te cilat favorizojne disa operator ekonomik dhe te krijojne nje treg te mbyllur per te tjeret.

Sikur te ishte vetem sperkates me emuluzion konsiderojme qe do te ishte ne rregulle mirepo gjysëm rimorikoe për mbushje të plasaritjeve të rrugeve me sperkates me emuluzion konsiderojmë që është kriter mësë i panevojshme për implementimin e projektit (vlen të përmendet që askund të paramasë nuk është kërkuar që të bëhet mbushja e plasaritjeve të rruges) ku edhe ky kriter është specifik dhe favorizues për një operator ekonomik apo grup të operatorëve ekonomik të caktuar dhe si e tillë kërkojmë që kjo pajisje të modifikohet dhe të jetë "sperkates me emuluzion".

Ju si Autoritet kontraktues duhet të siguroheni që të gjitha kriteret janë të drejtëpërdrejta, të arsyeshme dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, për të siguruar një proces të ndershëm dhe konkurrues.

Pergjigje per pretendimin tuaj te Dyte:

Duke analizuar ankesen tuaj per pretendimin tuaj te dyte AK kete pretendim e vlereson si pjeserisht te bazuar dhe AK do te ndryshoj pershkrimin per kete paisje

Pretendimi juaj i dyte eshte pjeserisht i Bazuar

Pretendimi ankimor 3

-Kamion kiper me peshe bartese max 1 tone

Per te siguruar nje konkurrence te drejte dhe transparente, dhe per te respektuar parimet e barazise dhe per te shmangur diskriminimin, kerkojme qe ky kriter te rishikohet dhe te modifikohet, te nilet pesha bartese ne te kunderien plotesisht kufizon konkurrencen dhe orientimi i timonit te percakton direkt tek nje OE.

Percaktimi i maksimumit te kesaj paisje shihet siptazi qe diskriminone operatorët ekonomike te cilet mund te ofrojne sherbime te cilasisa tejet te larte mirepo qe nuk disponojne pajisjet specifike te makinave te kerkuara nga ana e juaj si Autoritet Kontraktues.

Edhe ky kriter (te cilat i specifikuam me larte) te vendosur ne njoftimin per kontrate dhe ne dosjen e tenderit (kapaciteti i saj max 1 tone) perben shkelje e regullave te Ligjit te Prokurimit Publik.

Me qellim te sigurimit te kesaj paisje per ti plotesuar kriterat e dosjes se tenderit dhe njoftimit per kontrate ne kemi kontaktuar edhe qendren e rexhistrimeve dhe ne baze te ketyre zyrtareve rezultoi se kjo paisje (kamion kiper max 1 tone) nuk egziston, pra ketu lehtesisht vime ne perfundim qe operatori ekonomik i cili e posedon kete paisje ose e ka kamionet kiper me peshe bartese max 1 tone ose e ka falsifikuar kete dokument.

Pershtatja e kushteve te tenderit(kapacitete teknik dhe profesional) ne favor te disa operatorëve te caktuar i redukton mundesite per konkurrence te drejte dhe transparente, duke shkelur parimet e barazise dhe transparences qe garantohen nga ligji per prokurimin publik.

Pergjigje per pretendimin tuaj te Trete:

Sa i perket pretendimit tuaj te trete AK ka vlersuar se kjo paisje eshte e nevojshme per kete projekt dhe nje mjet i tille eshte i nevojshem per realizimin e puneve per vende te caktuara.

Pretendimi juaj i trete eshte i Pa Bazuar

Pretendimi ankimor 4

• Kamion cisternë për pastrim min. 18,000 Litra = 1 cope

Nuk është ofruar asnjë argument apo justifikim i qartë nga ana e juaj se përse keni vendosur një minimum të kësaj paisje (përdorisa në tregunë tone shumica apo 99% të kompanive e posedojnë këtë paisje më tepër me kapacitet të litra me të vogla e që konsiderojmë që është plotësisht në rregull) në raport me natyrën e punëve të cilat do të kryhen në terren për 10,000, 12,000, 13,000 Litra dhe kjo do të ndihmojë në realizimin e një procesi të drejtë dhe të hapur tenderimi, duke u mundësuar operatorëve të ndryshëm të ofrojnë shërbime të cilësive së kërkuar) më tepër vendosja e një minimumi 18,000 Litra krijon një dyshim të fortë se kriteret janë vendosur për të favorizuar operator të caktuar dhe për të kufizuar mundësitë e pjesëmarrësve të tjerë, duke minuar kështu parimet e barazisë dhe transparencës në procesin e tenderimit.

5/3

Minimumi 18,000 L është fare i panevojshëm sepse keni të bëjmë me mirëmbajtje dhe punën apo shërbimin e njëjtit e kryen edhe një paisje e cila posedon 10, 12, 13,000 L, se a mbushet cisterna nga ana e operatorit ekonomik 1 apo 2 apo 10 herë është nën domeni O/E e rëndësishme është që shërbimi kryhet i njëjti dhe konsiderojmë që këtij kriteri duhet t'i ulet kapaciteti në mënyrë që gara të jetë e re dhe të jua jepet hapsirë të gjithë operatorëve ekonomik.

Pergjigje per pretendimin tuaj te kater:

Duke analizuar ankesen tuaj per pretendimin tuaj te dyte AK kete pretendim AK e vlereson si te Pabazuar dhe nje paisje e tille eshte e nevojshme per kete projekt.

Pretendimi juaj i kater eshte i Pa Bazuar

Pretendimi ankimor 5

Llogë ngarkuese min 8 T ≈ 1 copë

Edhe ky kriter konsiderojme diskriminuese dhe i panevojshem per realizimin e ketij projekti pasi qe bazuar ne titullin e ketij aktiviteti te prokurimit dhe pozicionet e paramases vime ne perfundim qe seshite e demoshdeshme vendosja e kesaj paisje sepcse kemi te bejme me mirembajtje te asfaltit, dhe ne hapsiat e qytetit apo rrugicat e vogla te qytetit ku behet intervenimi me mirembajtje te asfaltit sepcse bazuar edhe ne verifikimin e rrugeve, rrugicave permes gjeoportalit vime ne perfundim qe egzistojne rruge te vogla ku edhe nese kerkohet paisja ne fjal duhet te jete me tonazh me te vogel se 8 tone.

Konsiderojme qe kjo paisje ose duhet te largohet si kriter i dosjes se tenderit dhe njoftimit per kontrate ose duhet ti ulet tonazhi ne raste shume specifike dhe te jashtezakonshme te intervenohet nga ana e OE, mirepo vendosja e minimumit te kesaj konsiderojme qe eshte e panevojshme sepcse perkundrazi mund te beje detyr ne rastet e intervenimit mbrenda hapsirave te ngushta ose ne sheshë.

Sa i perket pretendimit tuaj te peste AK ka vlersuar se kjo paisje eshte e nevojshme per kete projekt.

Pretendimi juaj i peste eshte i Pa Bazuar

Te gjitha shkrimet tuaja jane te pabazuara

AK ka zbatuar me përpikëri rregullat e nxjerra nga KRPP

Drejtori i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.

Bekim Shabani

Drejtor i Prokurimit